L I G J
Nr.7539, datë l7.12.1991

PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT NR.6800, DATË 29.6.1983 "PËR HETUESINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:
"Hetuesia është organ shtetëror i ngarkuar për hetimin e veprave penale. Ajo është e pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj dhe vepron në bazë të dispozitave kushtetuese e të ligjeve".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:
"Hetuesia varet administrativisht nga Ministri i Drejtësisë".

Neni 3

Në nenin 6, pas fjalëve "hetuesia në rreth", shtohen fjalët, si dhe hetuesia në njësitë ushtarake".

Neni 4

Neni 8 ndryshohet si vijon:
"Kryetari i Hetuesisë së Përgjithshme dhe zëvendësi i tij emërohen e shkarkohen nga Këshilli i Ministrave".

Neni 5

Nenet 2 dhe 3, shfuqizohen.

Neni 6

Çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.100, datë 25.12.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia